

VENDIM
Nr.421, datë 9.6.2005

PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË OBJEKTIT “ZYRAT DHE OFIÇINA”, SARANDË, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E USHQIMIT MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT DHE TË OBJEKTIT “ISH-PARKU I MALLRAVE”, SARANDË, NGA MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE E TELEKOMUNIKACIONIT MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.226, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT RRUGOR, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË TRANSPORTIT DHE TË TELEKOMUNIKACIONIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave
VENDOSI:

1. Objekti “Zyrat dhe ofiçina” të Drejtorisë së Ujërave, Sarandë, me sipërfaqe 6000 m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, dega Sarandë.

2. Objekti “Ish-parku i mallrave”, Sarandë, me sipërfaqe 1993,4 m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, për nevojat e bordit të kullimit, Sarandë.

3. Në vendimin nr.226, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, në listën bashkëlidhur, në formularin për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor, në bashkinë e Sarandës, në objektin me nr.1, “QKT-Sarandë”, të dhënat e kolonave 6 e 7, përkatësisht “Ish-PAM, Sarandë”, dhe “1993,4” zëvendësohen me “Zyrat dhe ofiçina e Drejtorisë së Ujërave, Sarandë” dhe “6000”.

4. Ngarkohen Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Transportit dhe i Telekomunikacionit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano